

S T A T U T I I SHOQËRISË "R.P.G" SH.P.K

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi;

Sot, në Tiranë, me datë 29.08.2023, Ortaku i vetëm i poshtëshënuar themeloi Shoqërinë "R.P.G" Sh.p.k, e cila do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

Ortaku i vetëm Shoqërisë është:

Z. Renato Podo, shtetas Shqiptar, lindur në Berat, më 10/07/1981 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID me Nr. Personal I10710092V.

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Themelimi, Forma dhe Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1** Krijohet Shoqëria "R.P.G" Sh.p.k.
- 1.2** Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.3** Shoqëria do të paraqitet me emërtimin tregtar "R.P.G" Sh.p.k. Ky emërtim do të jetë i vetmi që do të përdoret nga shoqëria në të gjitha regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretë apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.4** Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.5** Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e caktuar nga Ortakët e shoqërisë.

Neni 2

Themeluesi

- 2.1** Shoqëria është themeluar nga Ortaku i vetëm i saj: **Z. Renato Podo**.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

- 3.1** Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do të jetë:
"Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme: të angazhohet në shitjen dhe blerjen, qiradhënen dhe qiramarrjen, nënqira, huadħenien dhe huamarjen, të çdo lloj pasurie të paluajtshme si dhe të angazhohet ne shitje, blerje, qiradhenie, qiramarrje dhe perdonim te pasurive luajtshme, si automjete, mijete lundruese, etj. Te ushtruje aktivitet ne fushen e konstruksionit, rikonstruksionit, riparimit, shit-blerjes dhe qiradhenies se mijeteve lundruese. Te hap dyqane, degë apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Sherbime transporti, sherbime marketingu, menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkëpronësisë në prona dhe ndërtesa. Konsulencje financiare, ekonomike, juridike që ka lidhje me biznesin, me aktivitetet të



"Statuti i Shoqërisë "R.P.G" Sh.p.k"

- ndryshime tregtare të personave fizik dhe juridik. Shoqëria mund të kryej dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi".*
- 3.2** Shoqëria brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera, si brenda dhe jashtë vendit.
- 3.3** Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjpcionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

Selia e shoqërisë dhe degët

- 4.1** Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën: Rrugën "Liman Kaba", Kompleksi "Olympic Residence", Hyrja 1, Kati 2, Ap. 5, Tiranë Shqipëri.
- 4.2** Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Ortakut të Shoqërisë.
- 4.3** Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.
- 4.4** Zyrat, filialat, degët apo agjensitë krijojnë me Vendim të Ortakut të Shoqërisë, të cilët organizojnë punën dhe emërojnë organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

- 5.1** Kohëzgjatja e shoqërisë "R.P.G" Sh.p.k është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.
- 5.2** Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakëve të shoqërisë.
- 5.3** Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të ortakëve të shoqërisë.

**KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR**

Neni 6

Kapitali Themeltar

- 6.1** Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (Njëqind lekë) dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë. Kontributi i Ortakut të vetëm përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 6.2** Pronësia mbi kapitalin themeltar të shoqërisë është 100% (njëqind përqind) për Z. Renato Podo.
- 6.3** Kapitali themeltar është shlyer plotësisht nga ortaku i vetëm përparrë regjistrimit të kësaj shoqërie.
- 6.4** Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 7.1** Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë,

"Statuti i Shoqërisë "R.P.G" Sh.p.k"

nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.

- 7.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 7.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 7.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9
Organë Vendimmarrës

- 9.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;



- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.4** Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 9.5** Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 9.6** Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1** Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 10.2** Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 11

Kuromi

- 11.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 11.2** Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 11.3** Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor me lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

- 12.1** Asambleja e Përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2** Asambleja e Përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve

- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 12.3** Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.
- 12.4** Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme do të quhet i vlefshëm nëse votohet nga ana e ortakëve të shoqërisë duke qënë të pranishëm personalisht në mbledhjen e asamblesë, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike (e-mail) etj.

Neni 13

Përjashtimi nga e drejta e votës

- 13.1** Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - c) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 13.2** Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

KAPITULLI IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 14


Administratori

- 14.1** Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj:
- *Z. Bledar Podo, shtetas Shqiptar, lindur në Berat, më 26/01/1997 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Leterujoftim ID me Nr. Personal J70126005F.*
- 14.2** Administratori i shoqërisë emërohet me një afat 5 (pesë) vjeçar.
- 14.3** Administratori do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.
- 14.4** Kur administratori i shoqërisë rezulton i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financier të kompanisë, atëherë Ortakët e shoqërisë vendosin lidhur me shpërblimin që do ti jepet atij në fund të vitiit financier.

Neni 15

Kompetencat e Administratorit

- 15.1** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim; ;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpérblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KAPITULLI V VITI FINANCIAR , BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 16

Viti finanziar

16.1 Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, atë gjithë-vjetor dhe atë në lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU VI
PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidim

- 18.1** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njostuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me ligjin nr. 131/2015.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 18.2** Në këtë rast Ortakët merrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në édo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 18.3** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4** Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 19.1** Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- 20.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

- 21.1** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

Neni 22

Fitimi që shpërndahet

- 22.1** Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahen vendoset rast pas rasti nga Ortakët e shoqërisë sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Neni 23

Hyrja në fuqi

23.1 Ky statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortakët themelues të shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

***"R.P.G" Sh.p.k ***

Z. RENATO PODO

Renato Podo 